URDHËR
Nr. 195, datë 9.5.2012

PËR RISHPËRNDARJEN SIPAS NJËSIVE VENDORE TË NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË NOTERËVE TË CAKTUAR NË VITIN 2011 DHE SHPALLJEN E VENDEVE VAKANT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë, bazuar në studimin e kryer me ekspertizën e Misionit EURALIUS,

KONSTATON SE:

Në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë aktualisht veprimtarinë 292 noterë. Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 2140, datë 18.3.2011 "Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre sipas njësive vendore", numri i përgjithshëm i noterëve është 378, duke përcaktuar aktualisht si vende vakant 86. Referuar studimit, rishpërndarja e numrit të përgjithshëm të noterëve është bërë sipas standardeve ndërkombëtare, duke u bazuar në dy kritere:

1. Numri i popullsisë në njësitë vendore të caktuara;
2. Numri i transaksioneve.

Për sa më sipër, është sugjeruar që pa ndryshuar numrin e përgjithshëm të noterëve dhe pa bërë transferime, pozicionet e vendeve vakant duhen rishpërndarë. Për këtë qëllim, del e nevojshme që bazuar në studimin e mësipërm, të bëhet përcaktimi i numrit të noterëve sipas njësive vendore, bashki/komuna dhe vendet vakant të rishpërndahen bazuar në standardet ndërkombëtare.

Për këto arsye:

Ministri i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë", të ndryshuar,

URDHËRON:

1. Rishpërndarja sipas njësive vendore të numrit të përgjithshëm të noterëve, të jetë si më poshtë:

Bashkia/komuna	**Numri i noterëve**
- Bashkia Berat	8 (tetë)
- Komuna Kutalli	1 (një)
- Komuna Otllak	1 (një)
- Bashkia Kuçovë	3 (tre)
- Bashkia Çorovodë	1 (një)
- Bashkia Peshkopi	4 (katër)
- Komuna Maqellarë	1 (një)
- Bashkia Burrel	4 (katër)
- Bashkia Bulqizë	3 (tre)
- Bashkia Durrës	30 (tridhjetë)
- Bashkia Sukth	1 (një)
- Bashkia Shijak	3 (tre)
- Komuna Rashbull	1 (një)
- Bashkia Krujë	2 (dy)
- Bashkia Fushë-Krujë	2 (dy)
- Bashkia Elbasan	18 (tetëmbëdhjetë)
- Bashkia Cërrik	1 (një)
- Bashkia Belsh	1 (një)
- Bashkia Gramsh	3 (tre)
- Bashkia Peqin	2 (dy)
- Bashkia Librazhd	4 (katër)
- Bashkia Fier	13(trembëdhjetë)

- Bashkia Patos 1 (një)
- Komuna Levan 1 (një)
- Bashkia Lushnjë 10 (dhjetë)
- Bashkia Divjakë 1 (një)
- Bashkia Ballsh 2 (dy)
- Bashkia Gjirokastër 8 (tetë)
- Bashkia Tepelenë 2 (dy)
- Bashkia Përmet 2 (dy)
- Bashkia Korçë 14 (katërmbëdhjetë)
- Bashkia Maliq 1 (një)
- Komuna Pojan 1 (një)
- Bashkia Ersekë 2 (dy)
- Bashkia Pogradec 7 (shtatë)
- Bashkia Bilisht 4 (katër)
- Bashkia Kukës 5 (pesë)
- Bashkia Krumë 2 (dy)
- Bashkia B. Curri 2 (dy)
- Bashkia Lezhë 7 (shtatë)
- Bashkia Rrëshen 3 (tre)
- Bashkia Laç 3 (tre)
- Bashkia Mamurras 1 (një)
- Bashkia Shkodër 18 (tetëmbëdhjetë)
- Komuna Bushat 1 (një)
- Bashkia Pukë 2 (dy)
- Bashkia Fushë-Arrëz 2 (dy)
- Bashkia Koplik 2 (dy)
- Bashkia Tiranë 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë)
- Bashkia Kamëz 2 (dy)
- Bashkia Vorë 2 (dy)
- Komuna Farkë 1 (një)
- Komuna Kashar 1 (një)
- Komuna Paskuqan 2 (dy)
- Bashkia Kavajë 10 (dhjetë)
- Bashkia Rrogozhinë 1(një)
- Komuna Golem 1(një)
- Bashkia Vlorë 17 (shtatëmbëdhjetë)
- Bashkia Himarë 1 (një)
- Bashkia Orikum 1 (një)
- Komuna Qendër-Vlorë 1 (një)
- Bashkia Sarandë 8 (tetë)
- Bashkia Delvinë 2 (dy)

2. Shpallja e vendeve vakant, për ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, sipas njësive vendore, të jetë si më poshtë:

Bashkia/komuna	**Numri i noterëve**
- Bashkia Berat	2 (dy)
- Komuna Kutalli	1 (një)
- Komuna Otllak	1 (një)
- Bashkia Kuçovë	1 (një)
- Bashkia Peshkopi	1 (një)
- Komuna Maqellarë	1 (një)
- Bashkia Burrel	2 (dy)
- Bashkia Bulqizë	1 (një)
- Bashkia Durrës	2 (dy)

- Bashkia Sukth 1 (një)
- Komuna Rashbull 1 (një)
- Bashkia Elbasan 5 (pesë)
- Bashkia Cërrik 1 (një)
- Bashkia Belsh 1 (një)
- Bashkia Librazhd 1 (një)
- Bashkia Fier 4 (katër)
- Bashkia Patos 1 (një)
- Komuna Levan 1 (një)
- Bashkia Lushnjë 2 (dy)
- Bashkia Divjakë 1 (një)
- Bashkia Gjirokastër 3 (tre)
- Bashkia Korçë 5 (pesë)
- Bashkia Maliq 1 (një)
- Komuna Pojan 1 (një)
- Bashkia Ersekë 1 (një)
- Bashkia Pogradec 2 (dy)
- Bashkia Bilisht 2 (dy)
- Bashkia Kukës 1 (një)
- Bashkia Krumë 2 (dy)
- Bashkia B. Curri 1 (një)
- Bashkia Lezhë 2 (dy)
- Bashkia Rrëshen 1 (një)
- Bashkia Mamurras 1 (një)
- Bashkia Shkodër 3 (tre)
- Komuna Bushat 1 (një)
- Bashkia Fushë-Arrëz 2 (dy)
- Bashkia Koplik 1 (një)
- Bashkia Tiranë 5 (pesë)
- Bashkia Kamëz 2 (dy)
- Komuna Farkë 1 (një)
- Komuna Kashar 1 (një)
- Komuna Paskuqan 1 (një)
- Bashkia Kavajë 3 (tre)
- Bashkia Rrogozhinë 1 (një)
- Komuna Golem 1 (një)
- Bashkia Vlorë 3 (tre)
- Bashkia Himarë 1 (një)
- Bashkia Orikum 1 (një)
- Komuna Qendër-Vlorë 1 (një)
- Bashkia Sarandë 2 (dy)
- Bashkia Delvinë 2 (dy)

3. Pika 2 e urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 2140, datë 18.3.2011 “Për caktimin e numrit të përgjithshëm të noterëve dhe numrit të tyre sipas njësive vendore” dhe urdhri nr. 9025, datë 30.12.2011 i Ministrit të Drejtësisë “Për shpalljen e vendeve vakant, për ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, sipas njësisë vendore”, shfuqizohen.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri dhe dërgimin e tij për botim në Fletoren Zyrtare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi